



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-21285/25 datë:18.08.2025



Npi – 01/280 datë: 22.08.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 22.08.2025 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 22.08.2025 (e premte) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Besnik Ahmeti, DBF, z.Bardhyl Rushiti, DSHP, Zyrtarja për Informim znj.Vlora Hyseni, Praktikantët znj.Hava Llugaxhiu, znj.Admire Selmani dhe z.Albion Shabani. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 04.07.2025,
2. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal 2026-2028 (për diskutim publik),
3. Raporti gjashtëmujor Buxhetor Janar – Qershor 2025,
4. Raporti i Auditimit për Pasqyrën Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024 nga ZKA,
5. Plani i Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrës Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes,
6. Draft – Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Fillimisht i urojë Sadberes për pozicionin e ri nuk e di a është i përhershëm apo i përkohshëm por si do të të jetë urime. Unë pajtohem me pikat e rendit të ditës.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit, miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 04.07.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 04.07.2025.**

Pika 2

Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal 2026-2028 (për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përshëndetje. Ne e dime që çarkorja ka ardhur te ne me vonësë dmth. dhe prandaj edhe materiali për Kuvend ka ardhur me vonësë. Këtu në Komitetin materialin për Planin Buxhetor Komunal e kemi në pika të shkurta. Ndërsa për në Kuvend vjen materiali më i gjatë, sot po besoj e kryejmë. Në vazhdim lexoi materialin (shih dokumentin). Në përgjithësi kjo është e tëra për Komitetin, ndërsa për në Kuvend siç e thashë edhe më herët do e shtojmë materialin, sot para përfundimit të orarit të punës besoj vjen materiali.

z.Përparim Ramusa: Është buxhet që vjen prej Qarkores dhe ne nuk mundemi me ndryshu. Po më gëzon fakti që prej vitit tjetër po fillojmë me disa shërbime shtesë që realisht qytetarët tonë kanë shumë nevojë. Kisha propozuar që me i rekomandu Kuvendit që me dal në diskutim publik. Një sqarim deshta nga ju Drejtor, si është e mundur që përderisa numri i punëtorëve të QKMF-së po rritet si mundet me ndodhë kjo me u ulë buxheti?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Nuk thashë janë zvogëluar, thashë te buxheti i pagave është rritë ndërsa te kapitalet janë zvogëluar.

z.Muhamet Ademaj: Faleminderit Drejtor. E kam një vërejtje, disa projekte të propozuara në vitin e kalur nuk po i shohë që janë duke u realizuar, a është nevoja me i propozuar edhe një herë për Planin Buxhetor 2026-2028 apo ato mbesin si p.sh. trotuari te rruga "Hyrë Emini" nuk po realizohet. Po ashtu në Davidovc e kemi një rrugë "Mihal Grameno" që nuk po realizohet as ajo. Te lagja "Robojve" Petrovë kanalizimi nuk është rregulluar. Këto propozime mundën me u futë në këtë Plan Buxhetor.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Ky Plan Buxhetor do të shkojë në diskutim publik ku edhe mundeni me marrë pjesë dhe do të i diskutojmë të gjitha këto bashkarisht Profesor.

z.Muhamet Ademaj: Drejtor unë kisha dashtë që neve si subjekte politike me na thirrë që me e mbajtë një takim bashkë.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Patjetër Profesor, derën hapur e keni çdo herë, çka do që mundemi me bërë për këtë Draft-Buxhet, jemi për ta bërë më të mirën e mundshme për qytetarët dhe do vendosim bashkë me secilin.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik Planin Buxhetor Komunal 2026-2028.**

Pika 3

Raporti gjashtëmuor Buxhetor Janar – Qershor 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale si dhe në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi e prezantojmë këtë Raport. Sa i përket grantit Qeveritar buxheti i alokuar është 10.180,780.73 milion euro. Është një rritje e buxhetit gjatë këtij 6 mujori. Të hyrat vetanake janë 628,753.05 mijë euro. Arkëtimi i të hyrave vetanake është më i lartë në krahasim me vitin paraprak për 35.95%, në vazhdim lexoi materialin (shih dokumentin).

z.Muhamet Ademaj: Sa përqind e buxhetit është shpenzuar?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Buxheti është shpenzuar 47%. Faktikisht zvogëlimin e shpenzimit të buxhetit e ka bërë Ministria e Financave ku në fund të muajit Qershor në bazë të vendimit të Qeverisë e ka alokuar një shumë prej 262 mijë euro sepse ka qenë afër 50% diku rreth 49.6%. Ndërsa 18.31% të të hyrave vetanake janë shpenzuar, ndërsa deri në fund të vitit do të shpenzohet mbi 98% e buxhetit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit gjashtëmujor Buxhetor Janar – Qershor 2025**

Pika 4

Raporti i Auditimit për Pasqyrën Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024 nga ZKA

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Ky raport e ka titullin opinion i kualifikuar, për shkakë të shpenzimeve të cilat kanë rrjedhë si rezultat i kontratës kolektive. Raporti i ka 9 rekomandime, e prej të cilave 5 rekomandime janë të reja ndërsa 4 rekomandime janë të përsëritura. Në vazhdim lexoi materialin (shih dokumentin).

znj.Adelina Beqaj: Këto rekomandime që i përmende a janë të gjetura apo të përsëritura?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Te Plani i Veprimit ti tregojë se cilat prej këtyre rekomandimeve janë të reja e cilat të përsëritura. Sa i përket raportit të të hyrave vetanake janë rritë këtë vitë nëse e krahasojmë me vitin tjetër. Është raporti më i mirë në të gjitha Komunat e them me përgjegjësi të plot, nuk ka pas ndonjë shkelje që me i jap tjetër kahje këtij raporti. Nëse ka pyetje dikush jam këtu për të u përgjigjur.

z.Muhamet Ademaj: Te projekti i trotuarit në rrugën “Hyrë Emini” përmaburesi a i ka marrë parat apo jo?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Nuk e di sigurt më duhet me i shiku projektet.

z.Muhamet Ademaj: Te pagesa e mësimëdhënësve edhe sa ju ka borgj Komuna?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Borgji që Komuna ju ka mësimëdhënësve është shumë, në këtë vit obligime janë marrë afër 800 mijë euro, obligime janë d.m.th ato që e kanë formën e prerë.

znj.Adelina Beqaj: E pash një të gjetur te realizimi i projektit kapital, te cili projekt është fjala?

z.Besnik Ahmeti: Te rregullimi i murit mbrojtës në Reçak afër Kompleksit të asfaltuar rruga “15 Janari” është fjala.

znj.Adelina Beqaj: Drejtor po më duket që kemi shumë punë në Kuvend. Është edhe mos mbyllja e investimeve kapitale, kam dëshirë me i ditë specifikat se cili projekt kapital nuk është mbyllë, është e gjetur e auditorit gjë që na duhet me zbatu këtë pjesë.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Këtë është dashur me e zbatu në vitin 2016-2020, nuk është që ne nuk kemi dëshirë.

znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje. Faleminderit Drejtor për raportin. U vërejtën që janë 9 rekomandime. Sa i përket këtyre rekomandimeve të përsëritura sa mundemi që në vitin e ardhshëm mos me na ardhë prapë? Ndërsa te këto rekomandimet e reja po shihet, dy rekomandime janë nga kontratat kolektive, ku kontrata kolektive po na sjellë në pozitën që raporti neve me na dalë i kualifikuar. Mos mbyllja e investimeve në vijim për vitin 2016-2020 neve po na ndëshkon 4 ose 5 vjeqari i kaluar. Kjo është një e gjetur që është dashtë me u kry më herët. Prapë zvogëlimi i rekomandimeve nuk do të thotë që është keq.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit të Auditimit për Pasqyrën Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024 nga ZKA.**

Pika 5

Plani i Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrës Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Edhe këtu rekomandimet janë të njejta, vetëm është dashtë me u bërë një Plan i Veprimit. Unë jam për me përmbyll atë rekomandim sepse është në rregull edhe nga auditori, mirëpo ka arsye pse nuk janë mbyllë disa rekomandime. Si psh. te shkolla e Carralevës nuk ka pas pranim teknik. Nëse don me përmbyll një rekomandim, diçka ka me mungu edhe dikush ka me ju drejtu Prokurorisë, unë mendoj kështu. Kemi me u mundu me bërë të pa munduren për me i mbyllë në mënyrën më të mire të mundur.

z.Muhamet Ademaj: E di që ka shumë shkolla që kanë pas probleme me pranim teknik, psh shkolla e Pjeteshticës, a ka pas pranim teknik? Po ashtu shkolla “Emin Duraku” lartë ka pas probleme, a ka mundur që me u bërë pranimi teknik apo jo?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Zyrtari jonë është për me i mbyllë ato investime, ku e kërkon dokumentacionin te ai investitor dhe nëse mungon dokumentacioni nuk mundet me u mbyllë nëse e ka dokumentacionin e mbyllë atë investim dhe përfundon.

z.Lumni Amrushi: Te pjesa e fundit të ndëgjova për mos mbylljen e atyre kontratave. Të kisha inkuraju qysh sot me u marrë me këtë çështje dhe nëse ka të gjetura të i dërgoni në Prokurori. E ke obligim që me dërgu deri në fund këtë punë. Çdo kënd duhet me e dërgu në Prokurori. U shprehe gabimisht prej pozitës që e ke. E ke obligim atë të gjetur me mbyllë.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Nëse i shohim këto gjëra më shumë atëherë vlen të ceket që ne e kemi borgjin e AKP-së që e kemi falë e që dikush është dashtë me shku në Prokurori. Unë thashë vetëm që nuk u mbyll ajo e gjetur dhe tregova për cilën periudhë është vështirë me mbyllë.

znj.Adelina Beqaj: Nuk dyshoj për nga ana profesionale e juaj Drejtor, por nuk është në rregull me këtë qasje Drejtor. Qytetarët e dinë mire këtë që askush i PDK-së nuk është akuzuar për këto që po i thoni.

znj.Zejnije Veliu: Deshta te kjo pikë me u ndërlidh dhe me ju pyetë juve drejtor se a kish pas mundësi në seancën e Kuvendit me i listu objektet të cilat nuk e kanë pas pranimin teknik, këtë po du me e ditë si këshilltare e Kuvendit?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Patjetër që po.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Planit të Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrës Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes.**

Pika 6

Draft – Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjiilan

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha z.Bardhyl Rushitit.

z.Bardhyl Rushiti, DSHP: Përshëndetje. Ky Plan është votuar njëherë por është kthyer nga Ministria sepse zakonisht këto Plane kanë afat prej 15 dite për diskutim publik por është kërkuar që afati të zgjatet dhe të bëhet 30 ditë për shkakë që ka volumitet shumë të madhë. Po ashtu është kërkuar një pëlqim nga Ministria e Ambientit e pastaj të vjen në Kuvend, diçka tjetër nuk ka vetëm të vazhdohet në Kuvend që të votohet dhe të miratohet.


z.Muhamet Ademaj: Është jashtë temës pak, mirëpo Drejtor po e shohë që nuk keni mundur me zgjedhë një problem që po ekziston në Komunën e Shtimes rreth gjetjes së deponis për materialet e ngurta, po e shohë që po ka mbeturina në çdo pjesë të Komunës së Shtimes.

z.Bardhyl Rushiti, DSHP: Profesor unë pajtohem me ty qytetarët nuk kanë faj për këtë pjesë. Ne si Drejtori e kemi gjetë një lokacion e kemi bërë edhe kërkesën në Ministri por pasi që Qeveria nuk është ende funksionale, kjo kërkesë e jona ka mbetur vetëm në sirtarin e tyre. Kërkesën e kemi bërë ku ka qenë gurthyesi “Guri”, ai vend është pronë e pylltarisë.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime të tjera nuk ka, mbledhjen e përfundoj në ora 11:00h.

Procesmbajtës
Sadberre Halili





Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

